



*Adresa: Rruga "Bedri Çullhaj" 2, Njesia Administrative Nr.6, Tiranë. NUIS M11914021T
Cel: +355692708285; E-mail: hp.studioavokatie@gmail.com; av.ervinhajdinaj@hotmail.com*

Tiranë, më datë 21.07.2021

**VENDIM NR.1, DATË 21.07.2021
I ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË
"STUDIO AVOKATIE HAJDINAJ & PARTNERS" SH.P.K.
"MBI NJË SHITESË NË STATUTIN E SHOQËRISË"**

Sot më datë 21.07.2021, në ambjentet e selisë së shoqërisë "STUDIO AVOKATIE HAJDINAJ & PARTNERS" sh.p.k., u mbledh Asambleja e Përgjithshme e përbërë nga Ortaku i Vetëm, Z.Ervin Hajdinaj, për të diskutuar dhe më pas vendosur në lidhje me çështjen e rendit të ditës, mbi një shtesë në Statutin e shoqërisë.

Bazuar në dispozitat e ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, pikat 13.1 dhe 24.3 të statutit të shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme është kompetente për të bërë ndryshime në statut.

Sa më sipër, pas shqyrtimit të çështjes së mësipërme, Asambleja e Përgjithshme e përbërë nga Ortaku i Vetëm Z.Ervin Hajdinaj, e gjykon të arsyeshme marrjen e vendimit për të shtuar një dispozitë të re në Statutin e shoqërisë, dhe bazuar në ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar dhe dispozitat përkatëse të Statutit të shoqërisë:

VENDOS

1. Pas nenit 2 të Statutit të shoqërisë "STUDIO AVOKATIE HAJDINAJ & PARTNERS" sh.p.k., shtohet neni 2/1 me përmbajtje si vijon:

NENI 2/1

LOGO DHE VULA E SHOQËRISË

"Shoqëria ka logon dhe vulën e saj, me specifikimet si më poshtë:

- a) *Logo e shoqërisë përbëhet nga inicalet H dhe P, të bashkëngjitura, sipër të cilave gjenden dy pjatat e peshores dhe të rrethuara nga degët e kallirit të grurit, në ngjyrë si në të verdhë – siç tregohet në aneksin 1 bashkëlidhur këtij vendimi. Në të djathtë të logos, me gërma të mëdha shtypi shkruhet "STUDIO AVOKATIE HAJDINAJ & PARTNERS", me ngjyrë të bardhë. Fusha e logos është në ngjyrë blu të errët.*
- b) *Vula e shoqërisë është në formë rrethore, me diametër 35 mm, me ngjyrë blu të errët. Në gjysmën e sipërme të rrethit shkruhet "STUDIO AVOKATIE". Në*

1

gjysmën e poshtme të rrethit shkruhet "HAJDINAJ & PARTNERS". Në qendër të vulës gjendet logo e shoqërisë dhe NUIS M11914021T. Siç tregohet në aneksin 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ky vendim është pjesë integrale e Statutit të shoqërisë. Në statutin e shoqërisë reflektohen ndryshimet e bëra me këtë vendim dhe riprintohet në versionin e ndryshuar, duke u vulosur në faqen e fundit me vulën e shoqërisë.
3. Ngarkohet Administratori i shoqërisë, ose çdo person i autorizuar prej tij, të regjistrojë këtë vendim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"STUDIO AVOKATIE HAJDINAJ & PARTNERS"
ORTAKU I VETËM
ERVIN HAJDINAJ



ANEKS 1

LOGO E SHOQËRISË



A handwritten signature in blue ink, consisting of several overlapping, fluid strokes that form an abstract, cursive shape. The signature is located in the lower right quadrant of the page.

ANEKS 2

VULA E SHOQËRISË



A handwritten signature in blue ink, consisting of several overlapping, fluid strokes.

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "STUDIO AVOKATIE HAJDINAJ & PARTNERS "

Në bazë të ligjit nr.55/2018, datë 23.07.2018 "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë", Statutit të Dhomës së Avokatisë të Shqipërisë, Kodit Etik të Avokatit, ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, ligjit nr.9723, datë 03.05.2007, "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar, ligjit nr.131/2015, datë 26.11.2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", unë i nënshkruari:

- **Ervin Hajdinaj**, i biri i Astritit dhe Afërditës, lindur më 11.05.1986 në Fier dhe banues në adresën: *Lagjja Nr.14, Bulevardi "Migjeni", Nd.19, H.34, Ap.37, Tiranë*, shtetas shqiptar, identifikuar me letërnjoftimin me nr.personal I60511108Q, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, liçencuar nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë me Çertifikatë Nr.4870, datë 29.04.2011, për ushtrimin e profesionit të avokatit, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë dhe ushtrues aktiv i profesionit,

në cilësinë e Ortakut të Vetëm, **sot më datë 25.06.2021**, ditë e Premte, në Tiranë, miratoj statutin e shoqërisë "STUDIO AVOKATIE HAJDINAJ & PARTNERS" SH.P.K., me përmbajtje si vijon:

NENI 1 FORMIMI I SHOQËRISË

Themeluesi i shoqërisë "STUDIO AVOKATIE HAJDINAJ & PARTNERS", me përgjegjësi të kufizuar, është ortaku i vetëm, shtetasi:

- **Ervin Hajdinaj**, i biri i Astritit dhe Afërditës, lindur më 11.05.1986 në Fier dhe banues në adresën: *Lagjja Nr.14, Bulevardi "Migjeni", Nd.19, H.34, Ap.37, Tiranë*, shtetas shqiptar, identifikuar me letërnjoftimin me nr.personal I60511108Q, liçencuar nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë me Çertifikatë Nr.4870, datë 29.04.2011, për ushtrimin e profesionit të avokatit, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë dhe ushtrues aktiv i profesionit.

NENI 2 EMËRTIMI TREGTAR

Emërtimi tregtar i shoqërisë është **STUDIO AVOKATIE HAJDINAJ & PARTNERS**.

NENI 2/1 LOGO DHE VULA E SHOQËRISË

(shtuar me Vendimin Nr.1, datë 21.07.2021 të Ortakut të Vetëm të shoqërisë)

Shoqëria ka logon dhe vulën e saj.

- a) Logo e shoqërisë përbëhet nga inicalet H dhe P, të bashkëngjitura, sipër të cilave gjenden dy pjatat e peshores së drejtësisë dhe të rrethuara nga degët e kallirit të grurit,

në ngjyrë si në të verdhë. Në të djathtë të logos, me gërma të mëdha shtypi shkruhet "STUDIO AVOKATIE HAJDINAJ & PARTNERS", me ngjyrë të bardhë. Fusha e logos është në ngjyrë blu të errët.

- b) **Vula** e shoqërisë është në formë rrethore, me diametër 35 mm, me ngjyrë blu të errët. Në gjysmën e sipërme të rrethit shkruhet "STUDIO AVOKATIE". Në gjysmën e poshtme të rrethit shkruhet "HAJDINAJ & PARTNERS". Në qendër të vulës gjendet logo e shoqërisë dhe NUIS M11914021T.

NENI 3 SELIA E SHOQËRISË

3.1 Selia e shoqërisë është në adresën: Rruga "Bedri Çullhaj" 2, Njesia Administrative Nr.6, Tiranë, Shqipëri.

3.2 Shoqëria mund të themelojë degë dhe filiale në të gjithë territorin e vendit si dhe jashtë tij, me miratimin e organeve kompetente dhe në përputhje me legjislacionin e vendit ku do të hapen këto degë.

NENI 4 KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË EKONOMIKE

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është e pakufizuar.

NENI 5 OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë, bazuar në ligjin nr.55/2018, datë 23.07.2018 "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë", është si më poshtë:

"Ofrimi i shërbimeve avokatore. Këshillim ligjor për individët, personat fizikë (tregtarët) dhe personat juridikë, vendas dhe të huaj, në çdo fushë të së drejtës. Përfaqësim në procesin penal, civil, administrativ, tregtar dhe çdo fushë tjetër të së drejtës, në çdo shkallë të gjyqësorit. Përfaqësim pranë organeve të procedimit penal, pranë organeve të tjera shtetërore dhe administratës publike, pranë personave juridikë publikë e privatë, vendas dhe të huaj, pranë gjykatave ndërkombëtare, pranë çdo organizmi tjetër ndërkombëtar në të cilin Republika e Shqipërisë ka aderuar. Hartimi i akteve juridike dhe çdo akti tjetër, sipas kërkesave të individëve, personave fizikë (tregtarëve) dhe personave juridikë, vendas dhe të huaj. Kryerja e çdo veprimi dhe çdo lloj veprimtarie tjetër të lejuar nga ligji për ushtrimin e profesionit të avokatit. Bashkëpunimi me avokatë, zyra avokatie apo çdo lloj forme tjetër organizimi avokator, brenda apo jashtë vendit".

NENI 6 SIGURIMI I PËRGJEGJËSISË PROFESIONALE

Shoqëria merr masat e nevojshme për sigurimin e përgjegjësisë profesionale, sipas rregullave të përcaktuara në Statutin e Dhomës së Avokatisë të Shqipërisë.

NENI 7



2 / 7

NDRYSHIME NË TË DHËNAT E REGJISTRIMIT

Shoqëria mund të ndryshojë emërtimin e saj, selinë, objektin e aktivitetit në përputhje me lejimet e ligjit për ushtrimin e profesionit të avokatit, të afrojë ortakë të rinj, të rrisë kapitalin sipas vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 8 KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË

- 8.1** Kapitali i shoqërisë ndahet në një numër kuotash, në raport me kontributin e dhënë nga çdo ortak në shoqëri.
- 8.2** Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga **1 kuotë (pjesë), me vlerë 100 (njëqind) lekë. Kapitali themeltar është 100 % kontribut i ortakut të vetëm.** Kontributi i nënshkruar i kapitalit nuk është paguar.
- 8.3** Ortakët mund të vendosin për rritjen e kapitalit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme.
- 8.4** Detyrimet e çdo ortaku kundrejt shoqërisë përballohen deri në vlerën e papaguar të kapitalit të nënshkruar. Për detyrimet e tjera të shoqërisë ortaku nuk mban përgjegjësi.

NENI 9 PRANIMI I ORTAKËVE TË RINJ

Asambleja e Përgjithshme vendos për pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, të cilët duhet domosdoshmërisht të jenë avokatë.

NENI 10 DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Shoqëria tregtare deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave që përmban ky Statut, si dhe të legjislacionit shqiptar në fuqi mbi shoqëritë tregtare dhe regjistrimin e biznesit.

NENI 11 TRANSFERIMI DHE SHITJA E KUOTAVE

- 11.1** Pjesëmarrja e ortakëve në shoqëri përputhet me pjesët e tyre në kapitalin e shoqërisë.
- 11.2** Transferimi dhe shitja e kuotave ndaj të tretëve mund të bëhet pasi më parë kuotat i janë ofruar për blerje ortakëve të tjerë dhe këta kanë refuzuar blerjen. Realizimi i tyre bëhet në formë të shkruar dhe një kopje e këtij akti duhet të depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 11.3** Transferimi i kuotave në rrugë trashëgimie bëhet sipas neneve 73, 74, 75 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*", i ndryshuar. Të gjitha transferimet kanë efekt mbi shoqërinë që nga momenti i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Kuotat prej 1 (një) lekë janë të pandashme.

NENI 12



3/7

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë janë:

- i) **Asambleja e Përgjithshme**, e cila në momentin e themelimit të shoqërisë dhe deri në pranimin e ortakëve të rinj përbëhet nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë.
- ii) **Administratori**.

NENI 13

KOMPETENCAT E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

13.1 Asambleja e Përgjithshme është organi vendimmarrës i shoqërisë. Ajo ushtron të gjitha kompetencat që i janë caktuar në bazë të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar. Konkretisht, Asambleja e Përgjithshme ka kompetencat e mëposhtme:

- Përcakton politikat tregtare të shoqërisë.
- Bën ndryshime në statut.
- Miraton bilancin e shoqërisë dhe ndarjen e fitimit.
- Emëron dhe shkarkon administratorin, ekspertin dhe revizorin kontabël.
- Aprovon çdo lloj veprimi financiar që me ligj është kompetencë e saj.
- Mund të shfuqizojë ndalimin e konkurrencës (*Ligji nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, neni 17, pika 1.*), nëpërmjet një autorizimi të posaçëm.
- Përcakton shpërblimin për administratorin, ekspertin, revizorin kontabël.
- Bën transferimin e kuotave tek të tretët.
- Bën lidhjen e kontratave me organet shtetërore për pjesëmarrjen në tender, ankand ose aktivitete të tjera të rëndësishme, në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj.
- Realizon blerje, shitje si dhe tjetërsim të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të shoqërisë.

13.2 Marrja e vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme, mbajtja e procesverbaleve dhe të gjitha dokumentat e tjera që kanë të bëjnë me veprimtarinë e këtij organi vendimmarrës, hartohen dhe mbahen siç parashikohet në legjislacionin tregtar shqiptar.

13.3 Pjesëmarrja e nevojshme e ortakëve për të arritur në vendimmarrje, e të tjera në lidhje me vendimmarrjen, bëhen siç përcaktohet në nenet 86, 87, 88, 89 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

NENI 14

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

14.1 Shoqëria administrohet nga Administratori i shoqërisë. Administratori emërohet në detyrë për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje.

14.2 Asambleja e Përgjithshme vendos shpërblimin në favor të Administratorit për kryerjen e detyrës.

14.3 Administratori:



4 / 7

- ka liri të plotë për drejtimin e zakonshëm të shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha llojet e veprimeve dhe çdo lloj marrëveshje për realizimin e qëllimeve të shoqërisë, duke përjashtuar rastet që janë të parashikuara në ligj dhe në statut, që i përkasin Asamblesë së Përgjithshme;
- ka të drejtë të veprojë pranë çdo banke, duke kryer depozitim/derdhje shumash në llogari, tërheqje dhe transferta. Kjo e drejtë mund të kufizohet nga Asambleja e Përgjithshme;
- ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë pranë çdo institucioni publik e privat, të ndërmarrë veprime gjyqësore, transaksione të ndryshme, si dhe ka të gjitha të drejtat që janë parashikuar në ligj për administrimin e shoqërisë. Ky organ mund të lëshojë prokura, në kufijtë që i lejon Asambleja e Përgjithshme, për kategori të caktuara veprimesh;
- ushtron kompetencat duke respektuar ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar dhe konkretisht kapitullin " Mbi administrimin ", në nenet 31 e vijues të tij.

14.4 Administratori i shoqërisë, i emëruar për herë të parë, është shtetasi:

- **Ervin Hajdinaj**, i biri i Astritit dhe Afërditës, lindur më 11.05.1986 në Fier dhe banues në adresën: *Lagjja Nr.14, Bulevardi "Migjeni", Nd.19, H.34, Ap.37, Tiranë*, shtetas shqiptar, identifikuar me letërnjoftimin me nr.personal I60511108Q, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

NENI 15 DELEGIMI

Administratori mund të emërojë një ose më shumë persona të deleguar, ose përfaqësues të posaçëm, për të kryer veprime të veçanta, duke përcaktuar kompetencat e tyre, duke respektuar statutin dhe ligjet në fuqi, si dhe vendos dhënien e një shpërblimi në favor të tyre.

NENI 16 MARRËDHËNIET E PUNËS

Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe legjislacionit të punës në fuqi. Shoqëria merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të drejtat e punëmarrësit, ndërsa të punësuarit janë të detyruar që të respektojnë Statutin e shoqërisë dhe rregullat e brendëshme të saj. Të punësuarit duhet të përgjigjen për dëmet që i shkaktojnë shoqërisë nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

NENI 17 KONFIDENCIALITETI

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet të bëhet publike përmbajtja e të gjitha informacioneve, akteve dhe dokumentave që janë siguruar gjatë ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë.

NENI 18



5/7

ETIKA NË USHTRIMIN E PROFESIONIT

Avokatët dhe asistent avokatët e studios kanë detyrimin të sillen dhe ushtrojnë funksionin e tyre në përputhje me ligjin dhe Kodin e Etikës së Avokatit.

NENI 19 EKSPERTËT OSE REVIZORËT KONTABËL

Kontrolli mbi veprimtarinë e Administratorit dhe Asamblesë së Përgjithshme, si dhe gjithë aktiviteti i shoqërisë, i besohet një ekspertit ose revizorit kontabël të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme. Asambleja cakton edhe shpërblimin përkatës, në mungesë të normave të veçanta ligjore mbi pagesën apo shpërblimin e ekspertit apo revizorit kontabël.

NENI 20 BILANCI DHE FITIMET

20.1 Veprimtaria ekonomike e shoqërisë do të mbyllet më datë 31 Dhjetor të çdo viti. Administratori merr masa për hartimin e bilancit dhe rezultatin ekonomik fitim - humbje dhe inventar. Vendimin për miratimin e pasqyrave financiare (bilancit) e merr Asambleja e Përgjithshme.

20.2 Pasi paguhen detyrimet tatimore dhe veçohen fondet për zhvillimin e aktivitetit, të ardhurat që mbeten mund të ndahen mes ortakëve të shoqërisë dhe mund të transferohen lirisht jashtë shtetit, sipas dispozitave përkatëse ligjore.

NENI 21 LIBRAT E SHOQËRISË

21.1 Shoqëria mban librat e mëposhtëm:

- i) Libri i mbledhjeve dhe vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme.
- ii) Libri i mbledhjeve dhe vendimeve të ekspertëve ose revizorëve kontabël.
- iii) Regjistri i shërbimeve dhe veprimeve të avokatisë, i cili krijohet dhe administrohet në përputhje me formën dhe përmbajtjen e përcaktuar në Statutin e Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë.

21.2 Librat e mësipërm duhet të ruhen për një periudhë 10 vjeçare, e çdo faqe duhet të jetë e nënshkruar dhe vulosur.

NENI 22 MOSMARRËVESHJET MES ORTAKËVE

22.1 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë mes ortakëve të shoqërisë, ose mes tyre dhe shoqërisë, do të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet tyre.

22.2 Nëse nuk arrihet zgjidhja e mosmarrëveshjeve me mirëkuptim, gjykatë kompetente për zgjidhjen e konfliktit do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.



6 / 7

NENI 23
SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Në rast se shoqëria shpërndahet për çdo lloj arsye, Asambleja e Përgjithshme përcakton mënyrën e likuidimit, emëron një ose më tepër likuidatorë dhe përgatit të gjitha dokumentet e nevojshme për ç'regjistrimin e saj nga Qendra Kombetare e Biznesit. Dispozitat e ligjit mbi shoqëritë tregtare janë të zbatueshme.

NENI 24
DISPOZITË E FUNDIT

- 24.1** Përsa është shprehur në këtë statut, i është referuar ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*", i ndryshuar, ligjit nr.55/2018, datë 23.07.2018 "*Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë*", Statutit të Dhomës së Avokatisë të Shqipërisë dhe Kodit Etik të Avokatit.
- 24.2** Për sa nuk parashikohet në këtë statut, gjejnë zbatim dispozitat e ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*", i ndryshuar, ligjit nr.55/2018, datë 23.07.2018 "*Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë*", Statutit të Dhomës së Avokatisë të Shqipërisë dhe Kodit Etik të Avokatit.
- 24.3** Çdo ndryshim i dispozitave të këtij statuti bëhet në të njëjtën mënyrë siç është miratuar ky Statut.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"STUDIO AVOKATIE HAJDINAJ & PARTNERS "

ERVIN HAJDINAJ



